



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHERBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	04.06.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANINSKA	2885	2021	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHERBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.384/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.2736/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 30/04/2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.276/2019 të datës 14/05/2019 e parashtruar nga ankuesi me Adresë: D8-III, Nr.10, Ulpianë, Komuna e Prishtinës kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04/06/2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.276/2019 e datës 14.05.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër të lëndës 12-KA-2019 i datës 12.04.2019 i Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi ipas Vendimit me numër të referencës 07/1-01A/8314 të datës 03/12/2015 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar i Lartë Ligjor", në Drejtorinë-Zyra e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Operativës në Drejtorinë e Standardeve Profesionale, i cili me datë 26/02/2019 ka parashtruar kërkesën për ekzekutimin e pagesës me numër të referencës DPPK-01/04/ZL-1589/2019 tek Drejtor i Drejtorisë së personelit në Policinë e Kosovës, i cili e ka informuar se nga: "Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me datë 25.02.2019 kam pranuar konfirmimin se bashkë me pagën time të muajit mars 2016 është bërë ekzekutimi i pagesës në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 25% të

pagës mesatare", i cili pretendon se ky kompensim iu është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafit 1 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Me datë 08/03/2019 me numër të referencës 07/1-01A/2536 Shefi i Sektorit të Administratës dhe Personelit i kthen përgjigje ankues në kërkesën e tij të datës 26/02/2019, me të cilën e njofton se pagesa e shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të kaluara në punë pandërprerë në Policinë e Kosovës, jeni kompensuar më 25% të pagës mesatare sipas Rregullores Nr.33/2012 për Shtesa dhe Paga dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës si dhe e informon se çështja e shpërblimit jubilar nuk është e rregulluar ndryshe me aktet e brendshme normative po ashtu i bënë me dije se shpërblimin jubilar të 25% të pagës mesatare e ka pranuar në mars të vitit 2016 dhe nëse ka qenë i pa kënaqur me kompensim ka pas të drejtë që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të parashtrorj ankesë.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e datës 08/03/2019 me numër të referencës 07/1-01A/2536 të Shefit të Sektorit të Administratës dhe Personelit, me datë 25/03/2019 me numër të referencës DPPK-01/04/ZL-2532/2019 parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të dispozitave materiale.

Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës me datë 12/04/2019 merr Vendimin me numër të lëndës 127-KA-2019 i cili vendim është i protokolluar me datë 16/04/2019 me numër 01/02-165, me të cilin vendim ka hedhur poshtë si të pa lejuar ankesën e parashtruar nga ankuesi

Ankuesi pa kënaqur me Vendimin e Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës të datës 16/04/2019 me numër 01/02-165, me datë 14.05.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 2287/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16/05/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës më datë 23/05/2019 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/27.

Ankuesi ne datë 01.07.2019 ka parashtruar kërkesën nëpërmjet e-mail-it zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 2954/2019, me të cilën ka kërkuar informim nga Këshilli pse nuk ka marr ende vendim nga Këshilli.

Me datë 04.07.2019 me numër të protokollit 2995/2019 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesin lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 01.07.2019 për hapat e mëtejme që duhet të ndermirën. Pas njoftimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankuesi ka hap konflikt administrativë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila gjykatë merr Aktgjykimin me numër A.nr.2736/19 të datës 30/04/2021 të cilin aktgjykim Këshilli e ka pranuar

me datë 06/05/2021 me numër të protokollit 2234/2021, me të cilin aktgjykim aprovohet kërkesëpadia e paditësit i e bazuar dhe anulohet akti administrativ i të paditurës dhe e detyron Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos lidhur me ankesën e paditësit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimi A.nr.2736/19 i datës 30.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigja në kërkesën e ankuesit nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 04.07.2019; Kërkesa e ankuesit e datës 01.07.2019; Ankesa e ankuesit e datës 14.05.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 12.04.2019 i Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës; E-mail-at e datave 08.11.2018, 29.01.2019, 15.02.2019, 25.02.2019, 20.05.2019; Lista e pagave/kompensimi jubilar i ankuesit; Kërkesa e datës 26.02.2019 nga ankuesi e parashtruar për Drejtorinë e Personelit; Përgjigja në kërkesën për Interpretim Ligjor e datës 18.01.2019; Përgjigja e datës 08.03.2019; Ankesa e ankuesit e datës 25.03.2019 e parashtruar në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës; Kontrata e punës për Kontrata e punës për Quigley; Vendimi për caktim i datës 01.03.2006; Vendimi i datës 03.12.2015; Vërtetim i punës 20.05.2019 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/27.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e *pa bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që ti bëhet kompensimi i shpërblimit jubilar ashtu siç e përcaktoj dispozitat e nenit 52 paragrafit 1.1 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, i cili po ashtu e konteston edhe përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Ankesave si dhe afatshmërin lidhur me kërkesën e tij për shpërblim jubilar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që t'i bëhet pagesa e një page mujore me rastin e dhjetë (10) vjetorit të marrëdhënies të punës sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, Kolegji ka konstatuar që ankuesi ka statusin e nëpunësit civil dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet rrjedhin nga Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, po ashtu edhe kompensimet e nëpunësive civil janë të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, në këtë rast edhe mënyrat e kompensimit me rastin pagës jubilarë janë të rregulluara në bazë të këtyre ligjeve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës të dërguara nga palët, ka konstatuar se ankuesit i'u është bërë pagesa e shpërblimit jubilar me

rastin e dhjetë (10) vjetorit të punësimit në vlerë prej 93.71 € (nëntëdhjetë e tre e shtatëdhjetë e një cent), me pagën e muajit mars të vitit 2016, kështu që ankuesit i'u është realizuar shpërblimi jubilar prej njëzetepesë përqindëshi (25%) të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë që përcakton se: *"Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvojtorit (jubile)"* si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë nenit 21 i cili përcakton që: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*, rrjedhimisht ankuesi nuk mund të realizoj kompensimin siç përcaktohet me Kontratën e Përgjithshme Kolektive sepse neni 4 paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kontratën e Përgjithshme Kolektive e njeh si të aplikueshme vetëm për kategoritë e punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil, e që decidivisht e përcakton se: *"Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili e ka kontestuar përbërjen e dy anëtarëve të Komisionit të Ankesave pasi që ka pretenduar se dhe janë të uniformuar, Kolegji ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar sepse në bazë të kontratës të punës për kohë të pa caktuar të datës 15.09.2011 Kryesuesi i Komisionit të Ankesave ka gradën *"Kapiten Policor"* po ashtu edhe anëtarja e komisionit në bazë të kontratës të punës për kohë të pacaktuar ka gradën *"Kapiten"*, që të dy këto pozita janë të përjashtuara nga ligji i shërbimit civil në bazë të nenin 4 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku është përcaktuar se: *"...zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës,..."* nuk janë shërbyes civil dhe rrjedhimisht nuk mundën me qenë as anëtarë të Komisionit të Ankesave në bazë të nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku ka përcaktuar se: *"Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë nga radhët e nëpunësve civilë, me përgatitje superiore shkollore, emërohen nga Sekretariati i Përgjithshëm apo nga pozitat ekuivalente të institucioneve përkatëse në periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi, dhe pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor"*, andaj edhe mbi këtë bazë të potencuar më lartë vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kompetencës për shqyrtimin e ligjshmërisë së ankesës së ankuesit të datës 14.05.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit sa i përket afatshmërisë për parashtrimin e kërkesës për realizimin e shpërblimit jubilar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, Kolegji ka konstatuar, se në bazë të listës së pagave të muajit mars të vitit 2016, ankuesi iu është realizuar shpërblimi jubilar prej njëzetepesë përqind (25%), rrjedhimisht ankuesit afati për parashtrimin e ankesës në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës për shpërblim jubilar sipas Marrëveshjes të Përgjithshme Kolektive të Kosovës i ka rrjedh tridhjetë (30) ditë pasi që paga i ka dalë në xhirollogarinë e tij në

muajin mars të vitit 2016 me gjithë kompensimin e shpërblimit jubilar në vlerë prej 93.71 € (nëntëdhjetë e tre e shtatëdhjetë e një cent).

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.384/2021, datë 04/06/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Policisë së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

